



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



AKADEMIA E OJF-VE

HAP APLIKIMET PËR VITIN 2024

 Akademia e OJF-ve është një program i përvitshëm, zbatuar nga Partnerët Shqipëri, i cili kontribuon në rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të OJF-ve në nivele ekzekutive dhe manaxheriale mbi çështje të zhvillimit dhe manaxhimit organizativ, qëndrueshmërisë financiare, advokimit për çështje të interesit të përbashkët, forcimit të bashkëpunimit ndërsektorial etj.

Që prej 2015-ës, vit në të cilin programi u lançua për herë të parë, mbi 180 përfaqësues të OJF-ve shqiptare, me një shpërndarje të gjerë gjeografike, sektoriale dhe përfaqësimi gjinor, janë bërë pjesë duke përfituar njohuri dhe aftësi në drejtimin dhe manaxhimin efektiv të organizatave të tyre duke i ardhur në ndihmë grupeve të interesit për të cilat janë krijuar dhe publikut të gjerë.

Akademia e OJF-ve 2024 organizohet nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, projekt i financuar nga Bashkimi Evropian, zbatuar nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Lëvizjen Evropiane në Shqipëri, në kuadër të komponentit të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve në Shqipëri.

8

programe prej
vitit 2015

180

pjesëmarrës
në program

+20

bashki

11

leksione për çdo
program

40

lektorë dhe të
ftuar kombëtarë
dhe ndërkombëtarë

MBI AKADEMINË E OJF-VE

Organizatat e shoqërisë civile luajnë rol kyç në ndërgjegjësimin dhe edukimin e komunitetit, rritjen e aktivizmit dhe pjesëmarrjes qytetare në politikëbërje, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore e qendrore, si dhe ofrimin e shërbimeve për komunitetet lokale.

Ky rol bëhet akoma më i rëndësishëm në kushtet e zhvillimit të një sërë reformash të rëndësishme që po kalon vendi dhe procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Progres Raportet e viteve të fundit të Komisionit Evropian, vijojnë të vlerësojnë dhe theksojnë fuqizimin e shoqërisë civile si një komponent kyç i çdo sistemi demokratik. Angazhimi i shoqërisë civile si partner i fuqishëm në çuarjen përpara të prioritetëve dhe axhendave për adresimin e një spektri të gjerë çështjesh dhe problematikash në vend në nivel kombëtar dhe lokal, vlerësohet si thelbësorë, sidomos pas hapjes së negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Për të luajtur një rol më proaktiv në përmbushjen e funksioneve dhe roleve përmendur si më lart, organizatat jo fitimprurëse ende kanë nevojë për asistencë për zhvillimin dhe konsolidimin e tyre organizativ, ndërtimin e partneriteteve dhe zbatimin e ndërhyrjeve strategjike për të kontribuar qenësishëm në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.


Të dhënat statistikore të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, tregojnë për një rritje të vazhdueshme të sektorit të shoqërisë civile për nga numri i OJF-ve të regjistruara (**vetëm gjatë vitit 2022 janë regjistruar 275 OJF të reja**). Për më tepër, kuadri ligjor dhe financiar që rregullon aktivitetin e OJF-ve ka qenë subjekt i ndryshimeve dhe amendimeve të cilat kanë ndikuar në qëndrueshmërinë dhe aktivitetin e organizatave jofitimprurëse si dhe në marrëdhëniet e tyre me shtetin, ndaj njohja e tij nga ana e sektorit mbetet prioritet për të mundësuar një veprimtari efikente.



ÇFARË OFRON PROGRAMI?

- 1** Edukim jo-formal për të përforcuar aftësitë dhe zhvilluar kompetencat e drejtuesve të OJF-ve;
- 2** Rrjetëzim dhe ekspozim në nivel lokal, rajonal dhe multi-sektorial nëpërmjet metodave më bashkëkohore të të nxënit si dhe përvojës profesionale shumëdimensionale;
- 3** Krijon breza drejtuesish profesionistë dhe të angazhuar, që do të jenë aktorë të ndryshimit dhe kontribues në zhvillimin e shoqërisë Shqiptare.

✓ **Akademia e OJF-ve do të zhvillohet në periudhën Shkurt-dhjetor 2024 dhe do të konsistojë në:** ✓



KALENDARI DHE KURRIKULA E PROGRAMIT

1 shkurt 2024

Hapja e Akademisë - Kuadri ligjor për sektorin e OJF-ve në Shqipëri

Leksioni fokusohet në momente kyçe të zhvillimit të sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri, duke përfshirë kuadrin ligjor dhe tendencat gjatë 3 dekadave të fundit. Një vëmendje e veçantë i kushtohet Legjislacionit Fiskal për OJF-të, duke shqyrtuar aktivitetet ekonomike dhe joekonomike, regjimet tatimore, detyrimet, deklaratat para organeve tatimore dhe aspekte të tjera të lidhura me legjislacionin fiskal për organizatat joqeveritare.

22 shkurt 2024

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe roli i OJF-ve në këtë proces

Leksioni synon të rrisë njohuritë e pjesëmarrësve mbi hapat kryesore të procesit të anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian, strukturat e krijuara për procesin e negocimit, rolin e institucioneve kryesore që janë përgjegjëse për këtë proces, rolin e aktorëve të tjerë dhe grupeve të interesit, me fokus aktorët e shoqërisë civile. Objektivi final i leksionit është si rritja e informimit ashtu edhe e kapaciteteve për më shumë përfshirje në vendimmarrje dhe në monitorim, në kuadër të procesit të integritetit.

13 mars 2024

Zhvillimi organizativ dhe qeverisja organizative. Manaxhimi i burimeve njerëzore dhe procedurat e brendshme

Leksioni fokusohet në çështje që lidhen me qeverisjen e organizatave jo fitimprurëse si: strukturat qeverisëse, rolet, përgjegjësitë, politikat dhe procedurat e brendshme organizative dhe njihen me standardet bazë organizative, përmes prezantimit të Kodit të Standardeve të OJF-ve në Shqipëri. Përmes një analize të sistemeve aktuale, identifikimit të fushave për përmirësim në organizatat e tyre dhe prezantimit të modeleve efektive, synohet aftësimi i pjesëmarrësve në Akademi për të ndërtuar modele efektive drejtimi dhe menaxhimi në organizatat e tyre.

4 prill 2024

Manaxhimi financiar: Buxhetimi dhe kontabiliteti; Detyrimet dhe raportimet në shtet

Leksioni synon të rrisë njohuritë e pjesëmarrësve për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe parimet e tij, buxhetimin dhe kontabilitetin në organizatat jo fitimprurëse, pasqyrat financiare, analizën dhe raportimin si dhe detyrimet dhe raportimet në shtet. Prezantimi dhe diskutimi i këtyre çështjeve i ndihmon përfaqësuesit e organizatave të menaxhojnë më mirë financat e organizatave që ata përfaqësojnë, si dhe të mendojnë në mënyrë kritike për krijimin e qendrueshmërisë financiare.

25 prill 2024

Ngritja e fondeve. Sigurimi i mbështetjes nga grantet, fondet publike, filantropia dhe puna me sektorin privat

Leksioni ofron një perspektivë të përgjithshme të konceptit të ngritjes së fondeve dhe rëndësisë së tij për qendrueshmërinë financiare. Pjesëmarrësit njihen me mundësitë dhe tendencat e zhvillimit në financim nga donatorë të ndryshëm, duke përfshirë institucione publike, sektorin privat, programe të financimit të BE-së dhe donatorë të tjerë të huaj. Leksioni përfshin gjithashtu prezantimin e mënyrave alternative të suksesshme në ngritjen e fondeve si: përdorimi i platformave Crowdfunding, gjenerimi i të ardhurave nga shërbimet me pagesë etj., si dhe prezantimin e praktikave të mira në këtë drejtim nga përfaqësues të OJF-ve, biznesi, etj.

23 maj 2024

Sigurimi i mbështetjes financiare përmes granteve. Shkrimi i projekt-propozimeve dhe manaxhimi i projekteve, grantet e BE-së

Përmes këtij leksioni pjesëmarrësit njihen me formatin e aplikimit të projekt propozimeve për fonde të BE-së si dhe rrisin njohuritë në shkrimin e projekt propozimeve. Leksioni fokusohet gjithashtu në ciklin e menaxhimit të projektit, fazat e tij, analizën e sfidave si dhe në dhënien e rekomandimeve për ti kapërcyer këto vështirësi.

KALENDARI DHE KURRIKULA E PROGRAMIT

13 qershor 2024

Planifikimi strategjik

Leksioni synon të rrisë njohuritë e pjesëmarrësve mbi Planifikimin Strategjik, si një proces shumë i rëndësishëm i cili e orienton organizatën drejt planifikimit për vitet e ardhshme dhe strategjitë që do të përdorë për të arritur realizimin e qëllimeve të saj. Perspektiva, modele dhe qasje që përdoren në planifikimin strategjik, komponentët e procesit të planifikimit si dhe mënyra se si një plan strategjik zhvillohet në varësi të karakteristikave dhe kompleksitetit të organizatës, janë çështjet kryesore në të cilat fokusohet ky leksion.

4 korrik 2024

Advokasia dhe lobimi

Leksioni prezanton pjesëmarrësit me konceptin e advokasisë si proces që mobilizon, fuqizon dhe influencon vendimmarrjen dhe hartimin e politikave në nivel vendor dhe qendror. Si pjesë e leksionit, pjesëmarrësit rrisin njohuritë dhe aftësitë në dizejnimin e fushatave të advokasisë dhe përdorimin e teknikave të ndryshme për zbatimin e tyre, me qëllim adresimin e çështjeve në interes të komunitetit dhe/ose grupeve të interesit me të cilat organizatat punojnë.

6 shtator 2024

Mobilizimi i mbështetësve. Krijimi i rrjeteve dhe koalicioneve

Leksioni synon të rrisë njohuritë dhe të kuptuarit e pjesëmarrësve mbi konceptet e rrjetit dhe koalicionit, avantazhet dhe vështirësitë, modelet e organizimit dhe funksionimit, rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve, ndërtimin e përkushtimit zyrtar të partneritetit, komunikimin ndërmjet anëtarëve, etikën dhe menaxhimin e konflikteve ndërmjet partnerëve dhe anëtarëve etj. Përmes prezantimit të folësve të ftuar, përfaqësues të rrjeteve kombëtare, rajonale dhe më gjerë, pjesëmarrësit në Akademi njihen me eksperiencat dhe avantazhet e punës në rrjete, sfidat dhe menaxhimin e tyre, si dhe inkurajohen për partneritete dhe aktivitete të përbashkëta në të ardhmen.

25 shtator 2024

Komunikimi strategjik i OJF-ve

Leksioni synon të rrisë njohuritë dhe aftësitë e komunikimit efektiv në organizata me synim promovimin e punës si dhe rritjen e numrit të mbështetësve për programet e tyre. Hartimi dhe përcjellja e mesazheve efektive, hartimi i strategjisë dhe planit të komunikimit, prezantimi praktik me modele të përdorimit të medias publike, private, medias sociale dhe njohja e teknikave efektive të përcjelljes së mesazheve janë çështjet kryesore në fokus të këtij leksioni.

17 tetor 2024

Qeverisja me pjesëmarrje

Leksioni synon të rrisë njohuritë e pjesëmarrësve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes dhe kontributit të organizatave në politikëbërje dhe vendimmarrje në nivel vendor dhe qendror. Pjesëmarrësit prezantohen me mjete, mekanizma dhe platforma të përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile, grupeve të aktivistëve dhe grupeve të interesit, në politikëbërje dhe dialogun me institucionet, për një qeverisje sa më transparente, të përgjegjshme, efektive dhe më pranë qytetarëve.

10-24 nëntor
5 dhjetor 2024

Vizitë studimore Ceremonia e diplomimit.

NJIHUNI ME LEKTORËT



Av. Ardjana Shehi

Me një përvojë pune profesionale ligjore mbi 25 vjet dhe përvojë të gjatë profesionale me legjislacionin për sektorin jofitimprurës dhe, veçanërisht, me legjislacionin mbi regjimin tatimor të OJF. Krahës formimit si jurist (LLM & MBA), Av. Shehi ka patur formim të specializuar në lidhje me legjislacionin për OJF dhe regjimin tatimor për OJF nga ECNL (2002). Nisur nga viti 2000, Av. Shehi ka dhënë shërbime e konsulencë ligjore për shumë OJF vendase, të huaja dhe ndërkombëtare, si dhe agjensi zhvillimi të huaja dhe ndërkombëtare. Av. Shehi është autore, midis botimeve të tjera, edhe e shumë publikimeve mbi legjislacionin për OJF dhe legjislacionin tatimor mbi sektorin OJF. Av. Shehi është mbajtëse e certifikatës ndërkombëtare CIPD si trajnere dhe ka shërbyer si trajnere, lektore, folëse, etj., në shumë aktivitete trajnuese, konferenca, etj., mbi legjislacionin për OJF, legjislacionin përkatës (përfshirë legjislacionin kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit) dhe legjislacionin tatimor për sektorin OJF, të organizuar nga organizata vendase dhe ndërkombëtare.



Gledis Gjepali

Gledis Gjipali është Drejtor Ekzekutiv i EMA-s. Disa prej iniciativave më të rëndësishme të ndërmarra janë: Konventa e Integritetit Europian, një platformë bashkëpunimi midis institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile; Akademia e Integritetit Europian dhe Negociatave, për përgatitjen e ekspertëve nga sektorë të ndryshëm për negociatat e anëtarësimit në BE; revista EuroSpeak, një dritare informative mbi Bashkimin Europian etj. Gjatë eksperiencës së tij në Ministrinë e Integritetit Europian (2004-2008) ka qenë pjesë e ekipeve të punës për hartimin e dokumenteve strategjike si Plani Kombëtar i Përafrimit të Legjislacionit, Plani Kombëtar për zbatimin e MSA-së, etj., si dhe pjesëtar i grupeve të punës Shqipëri – BE. Ai ka publikuar studime dhe raporte të ndryshme në fushën e integritetit europian, negociatave dhe përfshirjen e shoqërisë civile, ndihmës së BE-së etj. Për disa vite ka qenë autori i raportit Vende në Tranzicion të Freedom House për Shqipërinë.



Entela Pinguli

Eksperte e shoqërisë civile në Evropën Juglindore me eksperiencë 25 vjeçare në zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve të shoqërisë civile, si OSHC, bashki dhe biznese në funksion të përmirësimit të kontributit të tyre në shoqëri. Me fokus në Ballkanin Perëndimor dhe ekonominë tranzicionale, Entela me ekspertizën e saj mundëson lehtësimin e dialogut të OSHC-ve me Komisionin Evropian, përmirëson partneritetet dhe mundëson pjesëmarrjen e OSHC-ve në debatet e politikave të BE-së. Ekspertiza e saj përfshin çështje të tjera si: zhvillimi strategjik, ngritja e fondeve, komunikimin dhe menaxhimin e projekteve, të mbështetura nga një formim akademik në inxhinieri kimike, duke e bërë atë një eksperte të menaxhimit mjedisor që adreson ndryshimet klimatike dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve. Entela gjithashtu kontribuon në monitorim dhe vlerësim të politikave në sektorë të ndryshëm.



Ilina Neshikj

Me një përvojë profesionale të konsiderueshme, në drejtim dhe koordinim të rrjetit global të OJF-ve - Accountable Now, Rrjetit Rajonal për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Ballkan (BCSDN), dhe së fundmi, rrjetin Civil Liberties Union for Europe. Ekspertiza e saj përfshin çështje të zhvillimit të shoqërisë civile si: zhvillimi organizativ, rrjetëzimi, qëndrueshmëria e OSHC-ve, përgjegjshmëria, si dhe komunikimi strategjik dhe advokimi. Ajo ka menaxhuar dhe punuar në projekte ndërkombëtare dhe globale me fokus përmirësimin e mjedisit mundësues për shoqërinë civile, kapacitetet e OSHC-ve dhe llogaridhënie, mbrojtjen e hapësirës qytetare dhe nxitjen për një pjesëmarrje më aktive të shoqërisë civile në politikëbërje.



Jetmira Hysenaj

Menaxhere Finance pranë Partnerëve Shqipëri që prej vitit 2011, me mbi 15 vjet përvojë në sektorin jo fitimprurës dhe atë financiar. Me një me përvojë të gjerë në planifikimin, buxhetimin dhe analizën financiare, kontabilitetin, taksat dhe programet e ngritjes së kapaciteteve financiare për sektorin jofitimprurës dhe fitimprurës.



Dr. Diana Djaloshi

Përvoja e saj profesionale në 25 viteve e fundit është ndërtuar rreth fushave të hartimit dhe menaxhimit të projekteve, advokimit, zhvillimit organizativ dhe planifikimit strategjik, duke përfshirë përvojën e saj aktuale si Menaxhere Programi në Korpusin e Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi. Ajo gjithashtu është angazhuar si konsulente, trajnere, eksperte monitorimi dhe vlerësimi me organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Znj. Djaloshi gjithashtu është e angazhuar pranë Partnerëve Shqipëri dhe Qendrës Kombëtare Burimore si trajnere/lektore në fusha të ndryshme duke përfshirë "Menaxhimi i Ciklit të Projektit", "Avokimi", "Qeverisja e Mirë" dhe "Planifikimi Strategjik".

NJIHUNI ME LEKTORËT



Prof. Asoc. Mihallaq Qirjo

Mihallaq Qirjo ka një angazhim të gjatë në lëvizjen mjedisore në Shqipëri dhe rajon. Ai drejton Qendrën Burimore të Mjedisit në Shqipëri (REC Albania) një organizatë jofitimprurëse që kontribuon në politikat mjedisore, edukimin dhe planifikimin në Shqipëri. Kontributi i tij përfshin hartimin dhe zbatimin e disa programeve mjedisore dhe zhvillimore në shkallë kombëtare dhe rajonale në fushën e strukturimit të politikave dhe institucioneve, pjesëmarrjes së publikut, edukimit, bashkëpunimit rajonal dhe dialogut. Një sërë projektsh janë fokusuar në ngritjen e kapaciteteve dhe rrjetëzimin ndërmjet OSHC-ve për të forcuar zërin e publikut dhe ndikimin në vendimmarrjen mjedisore dhe qeverisjen e mirë. Mihallaq Qirjo ka gjithashtu një përvojë akademike në fushën mjedisore, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Puna e tij akademike dhe kërkimore numëron mbi 30 punime shkencore, libra studimi, manuale trajnimi etj.



Blerjana Bino

Blerjana Bino është studiuese në shkencat sociale me fokus të veçantë në media, demokraci dhe pjesëmarrje. Ajo është kërkuese e Rrjetit të Gazetarëve të Sigurt në Ballkanin Perëndimor me përvojë të gjerë në vlerësimin e peizazheve mediatike në Ballkanin Perëndimor me fokus të veçantë në Shqipëri. Ajo është bashkëthemeluese dhe Drejtore Ekzekutive e Qendrës Shkencë dhe Inovacioni për Zhvillim duke punuar ngushtë me akademinë, shoqërinë civile, institucionet publike dhe mediat dhe drejton një rrjet studiuesish që punojnë në zhvillimin demokratik, qeverisjen e mirë, media dhe komunikim, bashkëpunimet kërkimore në shoqëri dhe transformimi digjital.



Ledina Gjiknuri

Me mbi 20 vite përvojë pune profesionale me fondet e BE-së, kryesisht instrumentin IPA. Ledina ka njohuri dhe aftësi të konsiderueshme në ciklin e menaxhimit të programit/projektit (hapat e tij dhe përgatitja e dokumenteve përkatëse) të fituara përmes përvojës në pozicione të ndryshme si vlerësuese, monitoruese, eksperte për ngritje kapacitetsh dhe institucionale etj.

Znj. Gjiknuri ka patur kryesisht përvojë në hartimin dhe ofrimin e trajnimeve për nëpunësit civilë për projektet IPA, ciklin e menaxhimit të projektit, dhe shkrimin e projekt propozimeve si pjesë e strukturës së koordinimit të programeve kombëtare dhe rajonale të IPA-s. Gjithashtu, përmes pozicioneve të tjera, ajo ka fituar njohuri të vlefshme dhe përvojë praktike me aktorë të ndryshëm të administratës publike shqiptare në nivel qendror dhe lokal dhe sektorit të shoqërisë civile.



Irena Myzeqari


Lektore e komunikimit në Universitetin European të Tiranës, që prej vitit 2012. Me një eksperiencë 10 vjeçare në fushën e medias dhe komunikimit si trajnuese, konsulente dhe mentore, puna e saj është e fokusuar në rritjen e kapaciteteve të individëve dhe organizatave në ndërtimin dhe zbatimin e planeve të qëndrueshme të komunikimit zhvillimor. Që prej vitit 2018 ajo ka qenë pjese aktive e programeve kombëtare dhe rajonale, duke kontribuar vazhdimisht në ndërtimin dhe fuqizimin e komuniteteve reziliente, në terma të rritjes personale dhe lidërshpit.



Prof. Asoc. Irida Agolli/Nasufi

Lektore me kohë të plotë pranë Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale në Universitetin e Tiranës që nga viti 2006. Ajo u diplomua si punonjëse sociale nga i njëjti departament në vitin 2001. Nga viti 2006 mban titullin Master i Shkencës (MSc.) në Punë Sociale nga Universiteti i Tiranës. Znj. Agolli ka mbrojtur gradën Doktor i Shkencave në vitin 2013 në të njëjtën fushë studimi si ajo e studimeve Master, rreth të drejtave të personave që jetojnë me HIV/AIDS në Shqipëri. Në vitin 2016 ka marr titullin Profesore e Asocuar. Fushat e saj të ekspertizës dhe interesit janë mbrojtja shoqërore, edukimi, politika sociale, të drejtat dhe mbrojtja e fëmijëve, përkatësi gjinore dhe zhvillim, të rinjtë, etj. Eksperiencat e saj të punës në këto fusha përfshijnë mësimdhënie në nivel Bachelor dhe Master dhe punë kërkimore shkencore të fokusuar kryesisht në çështje si nevojat e grupeve vulnerable, çështje social, të shëndetit dhe të drejtave, çështje gjinore, të edukimit, etj. Kurrikulumi i saj përfshin edhe konsulenca për institucione dhe organizata lokale dhe ndërkombëtare për kryerjen e kërkimeve, hartimin e dokumentave politike, përgatitjen e manualeve, ofrimin e trajnimeve, monitorim dhe vlerësim etj.

BËHU PJESË E PROGRAMIT



→ KUSH

Akademia është e hapur për drejtues të OJF-ve shqiptare në pozicionet: Drejtor Ekzekutiv, Manaxher Programi dhe Kryetar Bordi/Kryesie, të cilët synojnë rritjen e aftësive dhe zhvillimin e tyre profesional në këtë sektor për të ndërtuar organizata efektive në shërbim të publikut dhe grupeve të interesit.

→ SI

Kandidatët e interesuar për Akademinë e OJF-ve 2024 janë të ftuar të aplikojnë duke plotësuar Formën e Aplikimit.

Afati i fundit për dorëzimin e formës së aplikimit është **19 janar 2024 ora 17:00**.



KRITERET DHE PROCESI I PËRZGJEDHJES



Akademia do të mundësojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të sektorit me një shpërndarje të gjerë gjeografike dhe përfaqësim divers nënsektorial.



25 pjesëmarrës do të përzgjidhen për Akademinë e OJF-ve, 2024.



Përdorimi i literaturës dhe rasteve studimore do të kërkojnë nivel të mirë njohjeje dhe përdorimi të gjuhës angleze.

KANDIDATËT DO TË PËRZGJIDHEN BAZUAR NË:

Motivimin për ndjekjen e Akademisë;

Lidhjen ndërmjet rritjes individuale profesionale dhe zhvillimit të organizatës që drejton;

Angazhimin për të ndjekur të plotë programin e Akademisë dhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve si pjesë e tij.



Të gjithë të interesuarit duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë brenda afatit formën e aplikimit. Kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen brenda datës **24 janar 2024**.

Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të kontaktohen.



Shënim: POLITIKA JODISKRIMINUESE E PRANIMEVE NE AKADEMI

Në përzgjedhjen e pjesëmarrësve Partnerët Shqipëri do të udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit mbi baza gjinore, fetare, etnie apo orientimi seksual.



PËR MË SHUMË INFORMACION KONTAKTONI:
XHOANA ZEQQO

Koordinatorë e Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri



+355 4 225 4881



info@resourcecentre.al



resourcecentre.al



Rruga e Elbasanit, PARK GATE, Kati i
10-të, Ap. 73, Tiranë